



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 182

Tiranë – E Hënë, 1 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 150/2014 datë 6.11.2014	Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë 9359
Ligj nr. 151/2014 datë 6.11.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e shërbimeve mjedisore 9361
Ligj nr. 152/2014 datë 6.11.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si agjenci zbatuese për Fondin Global të mjedisit, për projektin e shërbimeve mjedisore..... 9372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 19.11.2014	Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme..... 9381
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 19.11.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)... 9383
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 19.11.2014	Për krijimin e fondit në mbështetje të industrisë fasonë.... 9383
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 19.11.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i Muzeut të Bashkëjetesës”, miratuar me vendimin nr. 1/2014, të Komitetit Shtetëror të Muzeve..... 9384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Fridis Tushe..... 9385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Liri Poda... 9385

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Anxhelika Hasani.....	9385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.790, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj.Ermira Bakalli.....	9386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Silvana Semini.....	9386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Fjori Shehu..	9386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.793, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Gentian Demaliaj.....	9387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Merita Kalani.....	9387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Majlinda Xhema.....	9387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 19.11.2014	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mark Kokaj	9388



LIGJ
Nr. 150/2014

**PËR PENSIONET E PUNONJËSVE QË
KANË PUNUAR NË MINIERA, NË
NËNTOKË**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ligji ka për qëllim rregullimin e pensioneve të pleqërisë për punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, me moshë, vjetërsi të përgjithshme dhe vjetërsi pune në profesion më të vogël se ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2
Subjektet përfituese

Subjektet përfituese janë:

a) punonjësit, të cilët deri në datën 30.9.1993 kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, sipas kritereve të përcaktuara në kreun I, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar.

b) punonjësit, të cilët pas datës 30.9.1993 kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, të dokumentuara sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e mësipërm, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitete ekonomike në subjekte private apo me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror.

Neni 3
Kushtet e përfitimit

Kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie si punonjës të minierave, në nëntokë, punonjësit, të cilët:

- a) arrijnë moshën 55 vjeç;
- b) kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12

vjet e 6 muaj në procese pune në miniera, në nëntokë, me përjashtim të ish-punonjësve të nëntokës që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët do të përfitojnë pension sipas këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjeç dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të veçantë financiar, nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë.

Neni 4
Masa e pensionit

Pensioni do të llogaritet sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 5
E drejta për përfitim

E drejta për të përfituar pensionin e pleqërisë, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.

Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë:

- a) nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte;
- b) nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.

Personi, i cili ka përfituar pension sipas këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve për periudhën/periudhat, gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetëpunësuar apo punëdhënës, me përjashtim kur vetëpunësohet në bujqësi.

Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër, gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.



Personi, i cili ka përfituar pension dhe kompensime në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të pensionit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Neni 6 Financimi

Përfitimet nga ky ligj financohen nga kontributet shtesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, dhe nga Buxheti i Shtetit.

Personat, të cilët do të kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të paguajnë kontribute shtesë, në masën 5 për qind të pagës bruto, për efekt kontributi. Kontributi shtesë paguhet 3 për qind nga punëdhënësi dhe 2 për qind nga punëmarrësi.

Kontributi i sigurimeve shoqërore, në masën 5 për qind, mbledhet dhe derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme, sipas procedurave për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Diferenca ndërmjet efektit financiar të këtij ligji, deri në plotësimin e moshës së përfituesve, sipas nenit 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me kontributin shtesë, do të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore, sipas paragrafit të katërt të këtij neni, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7 Kërkesa për përfitim

Pensioni jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij.

Faqe | 9360

Neni 8 Kompensimet

Për pensionet me datë fillimi para datës 1.1.2015, masës së pensionit, sipas nenit 4 të këtij ligji, do t'i shtohen edhe kompensimet për çmimet dhe për të ardhurat që përfitohen në rastin e pensioneve të pleqërisë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Përfitimet e caktuara sipas këtij ligji indeksohen me vendim të Këshillit të Ministrave sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë, nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

Neni 9 E drejta për të zgjedhur përfitimin

Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar si punonjës të minierave të nëntokës, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, që plotësojnë kushtet e këtij ligji, kanë të drejtë të zgjedhin mes përfitimit që kanë dhe përfitimit që u lind nga ky ligj.

Neni 10 Llogaritja e pensionit

Llogaritja, caktimi, administrimi dhe pagimi i pensioneve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave në fuqi për pensionet, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 11 Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 6 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 12 Dispozita të fundit

Ligji nr. 10 165, datë 15.10.2009, “Për caktimin e moshës së daljes në pension të punonjësve të nëntokës”, shfuqizohet.



Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.11.2014

Shpallur me dekretin nr. 8811, datë 24.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 151/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE MJEDISORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e shërbimeve mjedisore, me një hua në shumën 7 300 000 (shtatë milionë e treqind mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.11.2014

Shpallur me dekretin nr. 8812, datë 24.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Departamenti Ligjor

DRAFT KONFIDENCIAL

TEKSTI PËRFUNDIMTAR I NEGOCIUAR

(objekt ndryshimi)

Nightingale Rukuba-Ngaiza

30 prill, 2014

Huaja numër _____-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(PROJEKTI PËR SHËRBIMET
MJEDISORE) NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Datë _____, 2014

Marrëveshje e datës _____, 2014, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me shkronja kapitale, të përdorura në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që jepen në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve kohore dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej shtatë milionë e treqind mijë eurosh [7, 300,000 euro] (“Huaja”) ose ekuivalentin e saj pas konvertimit herë pas here sipas kursit të këmbimit, në përputhje me kushtet e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (Huaja), për të ndihmuar për financimin e pjesëve 1(a), 2(c) dhe pjesës 4 (a) të Projektit të përshkruar në pjesën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).



2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me seksionin IV të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e Angazhimit paguhet nga Huamarrësi dhe është e barabartë me çerekun e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Interesi që paguhet nga Huamarrësi për secilën Periudhë Interesi është i barabartë me nivelin¹ e referencës së monedhës së Huas, plus shpërndarjen fikse; me kusht që pas Konvertimit të të gjithë shumës së Principalit të Huas, ose të një pjese të tij, interesi i paguar nga Huamarrësi gjatë Periudhës së Konvertimit për këto shuma të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht nga çfarë specifikohet më sipër, në rast se mbetet e papaguar çdo lloj shume nga Bilanci i Tërheqjes të Huas pas datës së pagimit dhe në rast se mospagimi vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i paguar nga Huamarrësi llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e Pagesës janë 1 marsi dhe 1 shtatori i çdo viti.

2.06 Shuma e Principalit të Huas shlyhet në përputhje me afatin e amortizimit të parashikuar në pjesën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07. a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë Konvertimet e mëposhtme të Huas për të lehtësuar menaxhimin e kujdesshëm të borxhit: i) ndryshimin e Monedhës së Huas për të gjithë shumën e Principalit të Huas ose të një pjese të tij, të tërhequr ose të patërhequr, në një Monedhë të Miratuar; ii) ndryshimin e bazës së nivelit të interesit, për: A) të gjithë ose një pjesë të principalit të Huas së tërhequr dhe të mbetur nga një Nivel Variabël në një Nivel Fiks, ose e kundërta; ose B) të gjithë pjesën e shumës së principalit të tërhequr dhe të mbetur të Huas nga një Nivel Variabël bazuar në Nivelin e Referencës dhe Shpërndarjes Variabël në një Nivel Variabël bazuar në Nivelin Fiks të Referencës dhe Shpërndarjen Variabël, ose e kundërta; ose C) të gjithë shumën e Principalit të Huas së tërhequr dhe të mbetur nga Niveli Variabël bazuar në Shpërndarjen Variabël në një Nivel Variabël të bazuar në një Shpërndarje Fikse;

b) Çdo konvertim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni, që pranohet nga Banka, konsiderohet “Konvertim”, siç përkufizohet në Kushtet e Përgjithshme dhe hyn në fuqi sipas dispozitave në nenin IV të Kushteve të Përgjithshme dhe të Udhëzimeve për Konvertimin.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për përmbushjen e objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi e realizon Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit (MM), me ndihmën e AZHBR-së për qëllim të pjesës së 2-të të Projektit, në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton realizimin e projektit në përputhje me dispozitat e parashikuara në pjesën 2 të Marrëveshjes.

Neni 4 Hyrja në fuqi; përfundimi

4.01 Kushtet Shtesë të Hyrjes në Fuqi janë si më poshtë:

a) Huamarrësi përgatit dhe miraton një Manual Operacional për Projektin, i cili është i pranueshëm për Bankën;

b) Huamarrësi punëson një specialist prokurimësh dhe një specialist për menaxhimin financiar me kualifikimet, përvojën dhe me terma reference të pranueshëm për Bankën;

c) Marrëveshjet e bashkëfinancimit ekzekutohen dhe realizohen, si dhe përmbushen të gjitha kushtet që i paraprijnë hyrjes së tyre në fuqi, ose të drejtës së Huamarrësit për të kryer tërheqje bazuar në to (të ndryshme nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje).

4.02 Data e Fillimit të Huas është nëntëdhjetë (90) ditë pas hyrjes së kësaj Marrëveshjeje në fuqi.

Neni 5 Përfaqësimi; adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave i Huamarrësit.



5.02 Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4
Tiranë, Shqipëri
Faks: 355-4222-8494

5.03 Adresa e Bankës është:
International Bank for Reconstruction and
Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Adresa kabllore:Teleks:Faks:
INTBAFRAD248423(MCI) ose1-202-477-
6391
Washington, D.C.64145(MCI)

Rënë dakord në _____, _____,
në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

PJESA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivi i Projektit është të mbështesë praktika të qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe të rrisë përfitimet monetare dhe jomonetare të komuniteteve në zona të caktuara të Projektit, të cilat shtrihen kryesisht në zona të ngritura rurale, të prekshme nga erozioni.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit

a) Forcimi i kapaciteteve të Huamarrësit për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave, duke përfshirë:

i) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve për të zbuluar ndryshimet dhe për të dhënë informacion sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve për një periudhë ndërhyrje për të cilën do të bihet dakord;

ii) zhvillimin e një Inventari Kombëtar të Pyjeve të shtrirë në dhjetë vjet, nëpërmjet të cilit parcelat e kampionuara për mbulim nga pyjet dhe volum pyjor ekzaminohen çdo vit për dhjetë vjet rresht;

iii) mbështetjen e planifikimit të menaxhimit të pyjeve në pyjet prodhuese të menaxhuara nga shteti, duke përfshirë zonat e mbrojtura;

iv) krijimin e Sistemit shqiptar të Informimit për Pyjet;

v) forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë Rajonale të Pyjeve për të realizuar detyrimet e saj, duke përfshirë edhe monitorimin e pavarur të pyjeve; dhe

vi) regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që i janë transferuar komunave nga qeveria qendrore.

b) Realizimi i aktiviteteve për të fuqizuar përfituesit, duke përfshirë Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV), Shoqatat Komunale të Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave (SHKPPK), dhe fermerët për të përdorur praktika menaxhimi të qëndrueshëm të tokës dhe kullotave, duke përfshirë:

i) zbatimin e Planit Gjikor të Veprimit për të nxitur barazinë gjinore në menaxhimin e burimeve natyrore;

ii) mbështetjen e Grupeve Lokale të Veprimeve (GLV) për të kontribuar për strategjinë e zhvillimit;

iii) trajnimin e NjQV-ve dhe SHKPPK-ve për përdorim të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe tokave bujqësore; dhe

iv) nxitjen e gjenerimit të të ardhurave rurale nëpërmjet analizave të zinxhirit të vlerave, përgatitjes së planeve përpunuese dhe tregtimit të produkteve pyjore afatshkurtra dhe afatmesme.

Pjesa 2. Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës

a) realizimi i aktiviteteve për të përgatitur dhe zbatuar Planet Komunale për Mikrobaset (PKM) për përmirësimin e menaxhimit të tokës, duke përfshirë:

i) hartimin e udhëzimeve për përgatitjen e PKM-ve për nxitjen e përdorimit të integruar të burimeve natyrore;

ii) përgatitjen e PKM-ve për komunat e reja;



iii) përditësimin e Planeve ekzistuese Komunale të Menaxhimit të Pyjeve dhe të Kullotave (PKMPK), të cilat do të transformohen në KPM gjatë kohëzgjatjes së Projektit.

b) dhënia e granteve për përfituesit që i plotësojnë kriteret për realizimin e nënprojekteve;

c) forcimi i kapaciteteve të stafit të drejtorive rajonale të pyjeve, zyrës së pyjeve në rreth, AZHBR-së dhe i organeve të tjera të përfshira në shërbime bujqësore dhe pyjore, si dhe i aplikuesve të cilët do të realizojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në këtë Projekt.

Pjesa 3: Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore

Krijimi i mekanizmave financues për uljen e degradimit të tokës dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë:

a) përgatitjen e studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe krijimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe të verifikimit për të përcaktuar masën e karbonit të sekuestruar nëpërmjet aktiviteteve të Projektit;

b) zhvillimin e mekanizmave për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit për t'u siguruar se ata të cilët përfitojnë nga shërbimet mjedisore i paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve; dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit; dhe

c) pilotimin e mekanizmit për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit në zona të përzgjedhura.

Pjesa 4: Mbështetje për Zbatimin e Projektit

a) nëpërmjet realizimit të aktiviteteve për zbatimin e Projektit, duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore;

b) ofrimin dhe instalimit të sistemit të informacionit për monitorimin e Projektit për nxitjen e gjurmimit efektiv të aktiviteteve të projektit; dhe realizimin e sondazheve, auditeve mjedisore, monitorimit dhe vlerësimit.

PJESA 2

EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit

A. Masat institucionale.

1. Ekipi i Menaxhimit të Projektit

Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30

shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksionon dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka, duke përfshirë dhe sigurimin e koordinimit të përgjithshëm të menjëhershëm dhe eficient, zbatimin e përditshëm të Projektit dhe komunikimin e lidhur me aktivitetet dhe rezultatet e Projektit.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

a) Jo më vonë se data 30 shtator 2014, Huamarrësi krijon dhe më pas ruan në funksionim gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit një Komitet Drejtues të Projektit me përbërje, mandat dhe terma reference që janë të pranueshëm për Bankën.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e përmendur më sipër, Komiteti Drejtues i Projektit (KDP) drejtohet nga Ministria e Mjedisit dhe përfshin Drejtorin e Projektit, përfaqësues nga MM-ja, nga Autoriteti Menaxhues i MBZHRAU-së, AKM-ja, ZRPP-ja, AZHBR-ja, MF-ja, Departamenti për Programimin e Zhvillimit, Financimin e Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave, një kryetar komune dhe Federata Kombëtare e SHPPK-ve.

c) Huamarrësi merr masa që KDP-ja të takohet të paktën dy herë në vit dhe është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë, ndër të tjera: i) ofrimin e udhëzimeve strategjike dhe politikave; ii) lehtësimin e koordinimit të aktiviteteve të Projektit dhe kryerjen e rekomandimeve për eliminimin e pengesave për zbatimin e Projektit; dhe iii) rishikimin e progresit të bërë për arritjen e objektivit të Projektit.

3. Komiteti Teknik i Projektit

a) Huamarrësi, jo më vonë se data 30 shtator 2014, krijon dhe më pas mban gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit, Komitetin Teknik të Projektit, të drejtuar nga Drejtuesi i Projektit dhe që përfshin një Koordinator Projekti, koordinatore sipas komponentëve dhe staf teknik nga MM-ja dhe agjenci të tjera të përfshira në zbatimin e Projektit, me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, duke përfshirë: i) ofrimin e sigurimit të cilësisë për aspektet teknike të Projektit; ii) miratimin e Planit dhe Buxhetit Vjetor të Punës për transmetim të mëtejshëm të Banka; dhe iii) monitorimin e zbatimit të Projektit.



b) Pa u kufizuar në dispozitat e paragrafit (a), Huamarrësi siguron mbledhjen e Komitetit Teknik të Projektit të paktën një herë në çdo dy muaj.

B. Masat për zbatimin

1. Manuali Operacional i Projektit

Pa u kufizuar në dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi garanton që:

a) Projekti të kryhet në përputhje me Manualin Operacional të Projektit; dhe

b) Manuali Operacional i Projektit, ose pjesë të tij të mos ndryshohen, hiqen, pezullohen ose shfuqizohen pa njoftimin paraprak me shkrim të Bankës, dhe në rast të mospërputhshmërisë së dispozitave të Manualit Operacional të Projektit me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të kenë përparësi.

2. Nënprojektet

Gjatë zbatimit të pjesës 2 (b) të Projektit, Huamarrësi garanton, që:

a) përfituesit e përzgjedhur për marrjen e granteve të përzgjidhen në përputhje me kriteret e parashikuara në Manualin Operacional të Granteve.

b) nënprojektet të përzgjidhen, të vlerësohen dhe të zbatohen në përputhje me kriteret e pranimit dhe me procedurat e pranueshme për Bankën dhe të parashikuara në Manualin Operacional të Grantit, duke përfshirë kërkesat e mëposhtme:

i) nënprojekte të caktuara duhet të zbatojnë një PKMP ose KMP, ose të përmirësojnë praktika menaxhimi për përdorimin e tokës; ose t'u ofrojnë komuniteteve dhe fermerëve të caktuar mundësi dhe të ardhura alternative;

ii) të jenë teknikisht të qëndrueshme, ekonomikisht dhe financiarisht të përballueshme; dhe

iii) të mos përfshijnë zhvendosje jovullnetare.

c) Huamarrësi e përcakton secilin grant bazuar në një Marrëveshje Granti me Përfituesin përkatës sipas specifikimeve të miratuara nga Banka, të cilat përfshijnë si më poshtë:

1. Garancia jepet në lekë.

2. Huamarrësi gëzon të drejtat e nevojshme për të mbrojtur interesin e tij dhe interesat e Bankës, duke përfshirë të drejtën për të: i) pezulluar ose përfunduar të drejtën e Marrësit të Grantit për të përdorur të ardhurat nga Granti, ose rifinancim të të gjithë Grantit, ose të një

pjesë të tij të tërhequr deri në atë kohë, pas mosrealizimit nga ana e Marrësit të Grantit të detyrimeve të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje Granti; dhe ii) për t'i kërkuar çdo Marrësi Granti: A) të realizojë nënprojektin e tij me kujdesin dhe eficiencën e nevojshme dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e përshtatshme teknike, ekonomike, financiare dhe mjedisore të pranueshme për Bankën, duke përfshirë dhe përputhshmërinë me dispozitat e Udhëzimeve Antikorrupsion të zbatueshme për përfituesit e të ardhurave nga huat, të ndryshëm nga Huamarrësi; B) të ofrojë, sipas nevojës, burimet e nevojshme për këtë qëllim; C) të prokurtojë mallrat, punët dhe shërbimet që duhet të financohen nga Granti në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje; D) të ketë politika dhe procedura të përshtatshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin në përputhje me treguesit e pranueshëm për Bankën, progresin e nënprojektit dhe arritjen e objektivave të tij; E) 1. Të ketë një sistem menaxhimi financiar dhe të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit, të pranueshme për Bankën, të cilat zbatohen rregullisht, në mënyrë të përshtatshme për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me nënprojektin; dhe 2. Me kërkesë të Bankës ose Huamarrësit, të sigurojë auditimin e këtyre pasqyrave financiare nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me standardet e auditimit të zbatuara rregullisht dhe të pranueshme për Bankën, dhe të sigurojë paraqitjen e menjëhershme të pasqyrave të audituara te Huamarrësi dhe Banka; F) t'i lejojë Huamarrësit dhe Bankës të inspektojnë nënprojektin, funksionimin e tij, si dhe të dhënat dhe dokumentet përkatëse; dhe G) të përgatisë dhe t'i ofrojë Huamarrësit dhe Bankës të gjithë informacionin e kërkuar nga Huamarrësi ose nga Banka në mënyrë të arsyeshme në lidhje me sa më sipër.

3. Huamarrësi ushtron të drejtat e tij, siç parashikohet në secilën Marrëveshje Granti, në mënyrë të tillë që të mbrohen interesat e Huamarrësit dhe të Bankës dhe që të realizohen qëllimet e Huas dhe, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga Banka, Huamarrësi nuk transferon, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë nga asnjë



Marrëveshje Granti, ose asnjë prej dispozitave të një Marrëveshjeje Granti.

C. Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti

1. Huamarrësi përgatit dhe i jep Bankës jo më vonë se data 1 dhjetor e çdo viti fiskal gjatë zbatimit të Projektit një plan pune dhe një buxhet që përmban të gjitha aktivitetet e propozuara për t'u përfshirë në Projekt gjatë vitit fiskal pasardhës dhe një projekt-plan financiar për shpenzimet e kërkuara për këto aktivitete, duke parashikuar shumat e propozuara dhe burimet e financimit.

2. Huamarrësi i jep Bankës mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me të për secilin nga planet e propozuara të punës dhe buxhetet dhe, më pas, garanton që Projekti të zbatohet me kujdesin e nevojshëm pas këtij viti fiskal, në përputhje me këto plane pune dhe buxhete, siç miratohen nga Banka ("Plani dhe Buxheti Vjetor i Punës").

3. Huamarrësi nuk kryen ose nuk lejon të kryhen ndryshime në Planin Vjetor të Punës dhe në Buxhetin e miratuar pa miratimin paraprak me shkrim nga Banka.

D. Antikorrupsioni

Huamarrësi siguron që Projekti të kryhet në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve të Antikorrupsionit.

E. Garancitë

Huamarrësi e realizon Projektin në përputhje me dispozitat e KMM-së. Për këtë qëllim, nëse aktivitetet e përfshira në propozimin e Planit Vjetor të Punës dhe në Buxhet, bazuar në KMM, kërkojnë përgatitjen e një PMM-je, Huamarrësi siguron që të mos zbatohen aktivitete të tilla, me përjashtim të rasteve kur dhe derisa për këto aktivitete PMM-ja: i) të jetë përgatitur në përputhje me KMM-në dhe t'i jetë dhënë Bankës si pjesë e Planit Vjetor të Punës dhe e Buxhetit; ii) të zhvendoset lokalisht siç kërkohet nga KMM-ja; dhe iii) të miratohet nga Banka dhe të njoftohet publikisht.

Seksioni II. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

A. Raportet e Projektit

1. Huamarrësi monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranuar nga Banka. Çdo Raport Projektit mbulon një periudhë kalendarike gjashtëmujore dhe i jepet Bankës jo më vonë se një

muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Për qëllim të seksionit 5.08 (c) të Kushteve të Përgjithshme, raporti për ekzekutimin e Projektit dhe plani i lidhur me të, i cili kërkohet bazuar në këtë seksion, i jepet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Përfundimit.

B. Menaxhimi Financiar, Raportet Financiare dhe Kontrolli Financiar

1. Huamarrësi ruan ose merr masa për ruajtjen e një sistemi financiar menaxhimi në përputhje me dispozita e seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Huamarrësi përgatit dhe i jep Bankës, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik, raporte të përkohshëm financiare të paaudituar për Projektin që mbulojnë periudhën tremujore, në një formë dhe mënyrë që është e pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi i auditon Pasqyrat Financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të Kushteve të Përgjithshme. Secili kontroll i Pasqyrave Financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha i dërgohen Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të këtyre periudhave.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin, të cilat financohen nga shuma e Huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionin I të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e Konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga shuma e Huas prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara, ose të përmendura në seksionet I dhe IV të Udhëzimeve të Konsulentit dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat e shkruar me shkronja kapitale, të përdorur më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metoda të rishikimit të kontratave të caktuara nga Banka, i referohen metodës së përshkruar në seksionet II, III, IV dhe V të Udhëzimeve të



Konsulentit, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente

1. Tender i Hapur Ndërkombëtar. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente. Për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për kontratat e specifikuar në Planin e Prokurimeve, të ndryshme nga Tenderat e Hapur Ndërkombëtarë, mund të përdoren dhe metodat e mëposhtme: a) Tender i Hapur Kombëtar, objekt i dispozitave shtesë të parashikuara në paragrafin 3 të këtij seksioni; b) blerja; dhe c) kontraktimi i drejtpërdrejtë.

3. Modifikim i Procedurave të Tenderave të Hapur Kombëtarë. Procedurat e Tenderave të Hapur Kombëtarë (THK) bazohen në procedurat e Tenderave të Hapur, siç përcaktohet në ligjin e prokurimeve publike (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë të jetë objekt i dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e “Tenderit të Hapur”, siç përcaktohen në LPP-në e Shqipërisë zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga tenderimi dhe nuk ka preferencë të asnjë lloji për ofertuesit kombëtarë në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet e zotëruara nga shteti në Shqipëri lejohen të japin ofertën e tyre vetëm nëse ato janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe funksionojnë sipas ligjit tregtar të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi nuk përdoret si kriter kualifikues për ofertuesit;

c) Ofertat hapen në publik, në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, në praninë e përfaqësuesve që dëshirojnë të marrin pjesë;

d) Subjektet prokuruese përdorin dokumente tip tenderimi, siç miratohet nga Banka;

e) Në rastin e ofertave me çmime më të larta krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk skualifikohet pa miratimin paraprak të Bankës;

f) Për dorëzimin e ofertave përdoret një procedurë me një zarf të vetëm;

g) Postkualifikimi realizohet vetëm me ofertuesin më të ulët; në kohën e hapjes së ofertave nuk rrëzohet asnjë ofertë për shkak të kualifikimeve;

h) Ofertuesit në formën e një kompanie aksionare kanë përgjegjësi ligjore të përbashkët dhe të shumëfishtë;

i) Para skualifikimit të të gjitha ofertave dhe para pranimit të ofertave të reja, merret miratimi paraprak i Bankës;

j) Kontratat i jepen ofertuesit më të ulët, i cili është mjaftueshmërisht përgjegjës dhe që përcaktohet se është i kualifikuar për të kryer aktivitetin në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të njoftuara më parë për vlerësimin;

k) Negociatat pas ofertimit me ofertën e vlerësuar si më e ulëta, ose me ofertues të tjerë nuk lejohen;

l) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më tepër se 18 muaj) përmbajnë kushtet e nevojshme për rregullimin e çmimit;

m) Ofertat dhe garancitë e kontratave bëhen sipas formatit të përfshirë në dokumentet e tenderit. Garancia e tenderit është e vlefshme për njëzet e tetë ditë (28) pas vlefshmërisë fillestare të ofertës ose pas çdo periudhe zgjatjeje, nëse është e nevojshme. Asnjë pagesë paradhënie nuk mund të bëhet pa një garanci të përshtatshme për paradhënie.

n) Dokumentet e tenderimit dhe kontrata, siç konsiderohen të pranueshme për Bankën, përfshijnë dispozitat që deklarojnë politikat e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët, të cilët janë identifikuar se janë angazhuar në mashtrim ose korrupsion, siç përkufizohet në Udhëzimet e Prokurimeve; dhe

o) Në përputhje me Udhëzimet e Prokurimeve, çdo dokument tenderues dhe kontratë e financuar me të ardhurat e financimit parashikon që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit, dhe nënkontraktuesit, agentët, stafi, konsulentët, ofruesit e shërbimit, ose furnizuesit e tyre, e lejojnë Bankën të inspektojnë të gjitha llogaritë, të dhënat dhe dokumentet e tjera të lidhura me ofrimin e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe auditin e tyre nga audituesit e caktuar nga Banka. Aktet të cilat synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit dhe të drejtat e auditimit



të Bankës, të parashikuara në Udhëzimet e Prokurimeve, përbëjnë praktikë penguese, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimeve.

C. Metodatat e Posaçme të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve

1. Përzgjedhja bazuar në Cilësi dhe Kosto. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna bazuar në përzgjedhjen e bazuar në Cilësi dhe në Kosto.

2. Metoda të tjera prokurimi të shërbimeve të konsulentëve. Për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata të specifikuar në Planin e Prokurimeve, përveç metodës me Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe në Kosto, mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Përzgjedhja e bërë bazuar në cilësi; b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) Përzgjedhja e bazuar në koston më të ulët; d) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; e) Përzgjedhja me një burim të vetëm për kompanitë e konsulencës; f) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzimeve të Konsulentit për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë; dhe g) Procedura me një burim për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individide.

D. Rishikimi i vendimeve të prokurimeve nga Banka

Plani i Prokurimeve përcakton ato kontrata që do të jenë objekt i Rishikimit Paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i Rishikimit të Mëpasshëm nga Banka.

Seksioni IV. Tërheqja e të Ardhurave nga Huaja
A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme në këtë seksion dhe me udhëzimet e tjera shtesë të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Huamarrësit (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet për Projektet”, nxjerrë në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje në përputhje me këto udhëzime), për financimin e Shpenzimeve të Ligjshme, siç parashikohet në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Ligjshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Huaja (Kategori), ndarjen e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Ligjshme në secilën Kategori.

Kategoria	Shuma e Huas (EURO)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra dhe shërbime jokonsulente sipas pjesës 1(a), 2(c) dhe pjesës 4 (a) të Projektit	4,679,850	100%
2. Nënprojektet sipas pjesës 2(b) të Projektit	2,601,900	100%
3. Tarifa fillestare	18,250	Shuma që do të paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE	7,300,000	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pa cenuar dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk pranohet asnjë tërheqje:

a) për pagesa të kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) nënkategorinë 2 të Projektit nëse dhe derisa Huamarrësi: i) të përgatisë dhe të dorëzojë një Manual Operacional për Grantet, të pranueshëm për Bankën; dhe ii) të ketë përshtatur softuerin për menaxhimin e granteve për AZHBR-në për përdorim në Projekt në mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Data e përfundimit është data 30 shtator, 2019.

PJESA 3 AFATI I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton Datat e Pagesës së Principalit të Huas dhe përqindjen e shumës së përgjithshme të principalit të paguar në çdo Datë Pageje Principali (“Pjesa e Këstit”). Nëse të ardhurat e Huas janë tërhequr plotësisht që prej Datës së parë të Pagesës së Principalit, shuma e principalit të Huas e shlyeshme nga Huamarrësi për secilën Datë Pageje Principali do



të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Bilancin e Huas së Tërhequr që prej Datës së Pagesës së Principalit; me: b) Pjesën e Këstit për secilën Datë Pagimi të Principalit; kjo shumë e

shlyeshme rregullohet, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të kësaj pjese, mbi të cilat zbatohet Konvertimi/Këmbimi i Monedhës.

Data e Pagimit të Principalit	Pjesa e këstit (e shprehur në përqindje)
Çdo datë 1 mars dhe 1 shtator Duke filluar nga data 1 shtator e vitit 2021 Deri më 1 shtator 2033	3.85%
Më 1 mars 2034	3.75%

2. Nëse të ardhurat nga Huaja nuk janë tërhequr plotësisht në Datën e Pagimit të Principalit, shuma e shlyeshme e principalit të Huas nga Huamarrësi për secilën Datë Pagimi Principalit do të përcaktohet si më poshtë:

a) kur të ardhurat nga Huaja janë tërhequr që prej Datës së parë të Pagimit të Principalit, Huamarrësi paguan Bilancin e Tërheqjes së Huas që prej kësaj dite, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pjese;

b) çdo shumë e tërhequr pas Datës (së parë) së Pagimit të Principalit shlyhet në secilën Datë të Pagimit të Principalit, pas datës së kësaj tërheqjeje në shuma që përcaktohen nga Banka, duke e shumëzuar shumën e secilit prej këtyre tërheqjeve me një thyesë, emëruesi i së cilës është Pjesa e Këstit fillestar e specifikuar në tabelën në paragrafin 1 të kësaj pjese për Datën e Pagimit të Principalit (“Pjesa Fillestare e Këstit”) dhe me numërues shumën e të gjitha pjesëve të mbetura Fillestare të Këstit për Datat e Pagimit të Principalit që bien brenda kësaj date, ose pas kësaj date; këto shuma për shlyerje rregullohen, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të kësaj pjese, për të cilën zbatohet Konvertimi i Monedhës.

3. a) Shumat e Huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para Datës së Pagimit të Principalit, për qëllime vetëm të llogaritjes së shumave të principalit të paguara në Datën e Pagimit të Principalit, trajtohen si të tërhequra në Datën e dytë të Pagesës së Principalit, pas datës së tërheqjes dhe shlyhen në çdo datë pagese principalit që fillon me Datën e dytë të Pagesës së Principalit, pas datës së tërheqjes.

b) Pa cenuar dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem të përshtatshëm faturimi, sipas të cilit lëshohen faturat në Datën përkatëse të Pagimit të

Principalit, ose pas kësaj date, dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen më për asnjë tërheqje të bërë pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pa cenuar dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj pjese, me Konvertimin e Monedhës së të gjithë Bilancit të Tërhequr të Huas, ose të një pjese të tij, në një Monedhë të Miratuar, shuma e konvertuar në Monedhën e Miratuar që del gjatë Periudhës së Konvertimit dhe që shlyhet në datën e Pagimit të Principalit, përcaktohet nga Banka duke e shumëzuar këtë shumë me shifrën e përcaktuar menjëherë para konvertimit ose me: i) kursin e këmbimit që reflekton shumat e principalit në Monedhën e Miratuar të paguar nga Banka sipas Transaksionit të Këmbimit që lidhet me Konvertimin; ose ii) në rast se përcaktohet nga Banka, në përputhje me Udhëzimet e Konvertimit, me nivelin valutor që është komponent i Nivelit të Përcaktuar.

SHTOJCË

SEKSIONI I. PËRKUFIZIME

1. “LEK” është monedha e Huamarrësit.

2. “Sistemi i Informacionit për Pyjet në Shqipëri” është kuadri i teknologjisë së informacionit i projektuar për të marrë të dhëna ose informacion për pyjet dhe kullotat për të lehtësuar analizimin dhe raportimin e menaxhimit të integruar të pyjeve.

3. “Plani dhe Buxheti Vjetor i Punës” është plani i punës dhe buxheti i përgatitur çdo vit nga Huamarrësi dhe i miratuar nga Banka në përputhje me seksionin C të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje; dhe “Planet dhe Buxhetet Vjetore të Punës” nënkuptojnë më shumë sesa një plan dhe buxhet vjetor të punës.

4. “Udhëzimet Antikorrupsion” janë “Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftën kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huat e IBRD-s dhe Kreditë dhe



Grantet e IDA-s” të datës 15 tetor 2006, të rishikuar në janar të vitit 2011.

5. “AZHBR” është Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural e Huamarrësit e krijuar dhe që funksionon në përputhje me ligjin “Për zhvillimin bujqësor dhe rural” nr. 9817, datë 22 tetor 2007, ose pasuesi i tij ligjor.

6. “Përfituesi” është subjekti që ka të drejtë të ligjshme të marrë një grant sipas pjesës 2 (b) të Projektit, bazuar në kriteret e përzgjedhjes të parashikuara në Manualin Operacional të Granteve.

7. “Kategori” është kategoria e parashikuar në tabelën në seksionin IV të pjesës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

8. “Bashkëfinancues” janë Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), ose Fondi Global Mjedisor (Global Environmental Facility) (GEF) dhe “bashkëfinancues” është çdonjëra prej tyre.

9. “Bashkëfinancim”, në kuptimin e paragrafit 16 të shtojcës të Kushtet e Përgjithshme, është shuma prej dy milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë eurosh (€ 2,215,000), e cila do të jepet nga GEF-i; dhe b) gjashtëdhjetë e pesë milionë korona suedeze (SEK 65,000,000) që do të jepen nga Sida për financimin e Projektit.

10. “Marrëveshje Bashkëfinancimi” është marrëveshja e Grantit e GFE-së dhe Marrëveshja e Bashkëfinancimit e Sida-s.

11. “Shoqatat e Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave” janë organizatat joqeveritare që përfshijnë anëtarë të komuniteteve që përdorin burime pyjesh dhe kullotash brenda një zone të një njësie rurale të qeverisë vendore.

12. “Plan Komunal për Menaxhimin të Pyjeve dhe Kullotave” ose “PKMPK” është një instrument menaxhimi i hartuar nga komunitetet, i cili parashikon masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e tokës së pyjeve dhe kullotave për të paktën 10 vjet.

13. “Plani Komunal i Menaxhimit të Mikrobaseneve” ose PKMM-ja është një instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunitetet, i cili përshkruan masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e pyjeve, kullotave dhe tokës bujqësore për të paktën 10 vjet.

14. “Udhëzimet e Konsulentit” janë “Udhëzime: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve

për Huat e IBRD-së dhe për Kreditë dhe Grantet e IDA-s nga Huamarrës të Bankës Botërore”, nxjerrë në janar të vitit 2011.

15. “Këshilli i Ministrave” është dega ekzekutive e Huamarrësit e drejtuar nga Kryeministri.

16. “Departamenti i Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj” është departamenti i krijuar në Zyrën e Kryeministrit dhe që funksionon në bazë të urdhrin të Kryeministrit nr. 204, datë 1 nëntor 2013.

17. “Zyrat Pyjore të Rrethit” janë zyrat e Huamarrësit në nivel rrethi, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

18. “Kuai i Menaxhimit Mjedisor” ose “KMM” është kuai i përgatitur nga Huamarrësi që mban datën 23 janar 2014, i njoftuar po në të njëjtën datë, ku parashikohen modalitetet për skanimin dhe procedurat mjedisore për përgatitjen dhe zbatimin e planeve mjedisore të menaxhimit mbështetur në Projekt, dhe këto kushte përfshijnë të gjitha pjesët dhe shtojcat e KMM-së.

19. “Plani i Menaxhimit Mjedisor” ose “PMM” lidhet me çdo aktivitet të bazuar në Projekt, mbështetur në të cilin KMM-ja kërkon një plan menaxhimi mjedisor. Ky plan përgatitet në përputhje me dispozitat e seksionit 1. E të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje; dhe “PMM-të” janë më shumë sesa një.

20. “Plan Gjinator Veprimi” është plani i përgatitur nga Huamarrësi i datës 7 nëntor 2013 për të forcuar pjesëmarrjen e grave në të gjitha aktivitetet e projektit dhe që përbën pjesë të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të Projektit.

21. “Marrëveshja e Grantit e GEF-s” është marrëveshja që do të nënshkruhet ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, e cila vepron si Agjenci Zbatuese e Fondit Global Mjedisor (GEF), e cila i ofron një grant Huamarrësit për të ndihmuar për financimin e pjesëve 1 (a), 2(a) dhe 3 të Projektit, sipas ndryshimeve që pëson marrëveshja herë pas here. “Marrëveshja e Grantit e GEF-s” përfshin të gjitha shtojcat, pjesët dhe marrëveshjet përbërëse të Marrëveshjes së Grantit të GEF-së.

22. “Kushtet e Përgjithshme” janë Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Dhënie Huaje”, datë 12 mars 2012.”



23. “Grant” është granti i dhënë nga të ardhurat e Huas për një Përfitues për të realizuar një nënprojekt në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në Manualin Operacional të Grantit.

24. “Manuali Operacional i Grantit” është manuali që përgatitet dhe miratohet nga Huamarrësi në përputhje me seksionin 1V. B.1 (b) (i) të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

25. “Marrëveshja e Grantit” është marrëveshja e përmendur në seksionin 1.B.2(c) të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

26. “ZRPP” është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme të Huamarrësit, e krijuar në përputhje me ligjin për regjistrimin e pasurive të patundshme nr. 33/ 2012 ose pasuesve të tij ligjorë.

27. “Grupi Lokal i Veprimit” është partneriteti ndërmjet subjekteve publike, private dhe shoqërisë civile në nivel rajoni për të zhvilluar zonën rurale.

28. “MBZHRAU” është Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit e Huamarrësit, ose pasuesi ligjor i saj.

29. “Autoriteti Menaxhues i MBZHRAU-së” është Departamenti i Zhvillimit Rural në MBZHRAU.

30. “MM” është Ministria e Mjedisit e Huamarrësit ose pasuesi ligjor i saj.

31. “MF” është Ministria e Financave e Huamarrësit ose pasuesi ligjor i saj.

32. “Federata Kombëtare e SHPPK-ve” është një organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në territorin e Huamarrësit.

33. “Inventari Kombëtar i Pyjeve” ose “IKP” është një regjistër i të dhënave mbi pyjet, i marrë nga informacioni i ofruar nga imazhet satelitore, me qëllim krijimin e një vlerësimi kombëtar të mënyrës sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve brenda një periudhe të caktuar.

34. “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e Huamarrësit, e krijuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29 janar 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare Mjedisore dhe Agjencive Rajonale Mjedisore” ose pasuesit ligjorë të tyre.

35. “Kostot Operative” janë kostot me rritje

të arsyeshme graduale që dalin nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzime për pajisje, për stafin e MM-së dhe AZHBR-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, dietat për nëpunësit civilë, pajisjet (duke përjashtuar pagat për nëpunësit civilë), orenditë, materialet dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe kostot e lëndës djegëse për vizitat në terren.

36. “Pagesa për Shërbime Mjedisore” është pagesa që u ofrohet individëve ose grupeve në këmbim të përdorimit ose praktikave të qëndrueshme të tokës.

37. “Pagesa për Shërbimet e Ujëmbledhësit” është pagesa që u ofrohet individëve ose grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të ujëmbledhësit.

38. “Udhëzimet e Prokurimeve” janë “Udhëzimet: Prokurimet e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente për Huat e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, nxjerrë në janar 2011².

39. “Plani i Prokurimeve” është plani i prokurimeve të Huamarrësit për Projektin, datë 29 prill 2014 dhe përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit, siç përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të përmendur më sipër.

40. “Ekipi i Menaxhimit të Projektit” është ekipi i Huamarrësit i përbërë nga stafi i caktuar nga MM-ja, Koordinatorin e Projektit, specialistin e prokurimeve dhe stafi tjetër që do të rekrutohet për Projektin, në përputhje me seksionin I.A.1 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

41. “Manuali Operacional i Projektit” është manuali i përgatitur në përputhje me seksionin II. A të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe i konfirmuar si i pranueshëm nga Banka, i miratuar nga Huamarrësi, ku përshkruhen dhe përcaktohen procedurat dhe masat institucionale për zbatimin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e Projektit.

42. “Drejtoria Rajonale e Pyjeve” është një



njësi qeveritare brenda MM-së, përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe me shërbime të shtrira në nivelin e qarqeve, e krijuar dhe në funksionim në përputhje me ligjin për pyjet dhe shërbimin pyjor nr. 9385, datë 4 maj 2005 ose dokumentet pasardhëse ligjore.

43. “Marrëveshja Bashkëfinancuese e Sida-s” është marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, e cila ofron një grant në shumën prej gjashtëdhjetë e pesë milionë koronash suedeze (SEK 65,000,000) për Bankën për të ndihmuar për financimin e Projektit apo çdo ndryshim i mëvonshëm i kësaj Marrëveshjeje. “Marrëveshja Bashkëfinancuese e Sida-s” përfshin të gjitha shtojcat, tabelat dhe marrëveshjet që i bashkëlidhen Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të Sida-s.

44. “Nënprojekt” është një nënprojekt i përzgjedhur dhe i miratuar nga Huamarrësi, i cili do të financohet nga një grant, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në Manualin Operacional të Granteve.

LIGJ

Nr. 152/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
AGJENCI ZBATUESE PËR FONDIN
GLOBAL TË MJEDISIT, PËR
PROJEKTIN E SHËRBIMEVE
MJEDISORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si agjenci zbatuese për Fondin Global të Mjedisit, me një grant në shumën 2 880 000 (dy milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë) USD, për projektin e shërbimeve mjedisore, sipas tekstit

Faqe | 9372

bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.11.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8813, datë 24.11.2014
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Departamenti Ligjor
DRAFT KONFIDENCIAL
(objekt ndryshimi)
TEKSTI I NEGOCIATAVE
Nightingale Rukuba-Ngaiza
30 prill, 2014

NUMRI I GRANTIT GEF _____

FONDI PËR MJEDISIN GLOBAL
MARRËVESHJE GRANTI
(PROJEKTI PËR SHËRBIME
MJEDISORE)
NDËRMJET

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
dhe

BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
në cilësinë e Agjencisë Zbatuese të Fondit për
Mjedisin Global

Datë _____, 2014

NUMRI I GRANTIT GEF _____
MARRËVESHJE GRANTI E FONDIT
PËR MJEDISIN GLOBAL

Marrëveshje e datës _____, 2014, e nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Marrësi); dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e agjencisë zbatuese të Fondit për Mjedisin Global (GEF).

Përfituesi dhe Banka Botërore bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet Standarde; Përkufizimet

1.01 Kushtet Standarde për Grantet e Dhëna nga Banka Botërore nga Fondet e Ndryshme, të



datës 15 shkurt 2012 (Kushtet Standarde), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat e shënuara me shkronja kapitale në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që përcaktohet për to në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshje.

Neni 2 Projekti

2.01 Përfituesi deklaron angazhimin e tij për përbushjen e objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi e realizon Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit (MM), me ndihmën e AZHBR-së për qëllim të Pjesës së dytë të Projektit, në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve Standarde.

2.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 2.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe me përjashtim të rasteve kur Përfituesi dhe Banka Botërore bien dakord ndryshe, Përfituesi garanton realizimin e projektit në përputhje me dispozitat e parashikuara në pjesën 2 të Marrëveshjes.

Neni 3 Granti

3.01 Banka Botërore bie dakord t'i japë një grant Përfituesit, sipas afateve kohore dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, një grant prej dy milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë dollarësh amerikanë [2, 880,000 dollarë] (Granti) për të ndihmuar për financimin e Pjesëve 1 a), 2 a) dhe 3 të Projektit.

3.02 Përfituesi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Granti në përputhje me seksionin IV të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3.03 Granti financohet nga fondi i besimit, i përmendur më sipër, për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatorë dhe nga fondi i besimit. Në përputhje me pjesën 3.02 të Kushteve Standarde, detyrimet e pagimit nga Banka Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara nga fondet që i vihen në dispozicion nga donatori/donatorët bazuar në fondin e besimit të përmendur më sipër, ndërsa e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat nga Granti varet nga disponueshmëria e këtyre fondeve.

Neni 4

Mjete Efektive Shtesë

4.01 Rasti Shtesë i Pezullimit, i përmendur në pjesën 4.02 "k" të Kushteve Standarde, përbëhet nga sa më poshtë:

a) Kur Marrëveshja e Bashkëfinancimit për ofrimin e bashkëfinancimit (Bashkëfinancimi) për këtë Projekt nuk ka hyrë në fuqi; ose në një datë ose data të tilla të mëvonshme të përcaktuara nga Banka Botërore pas njoftimit të Përfituesit; gjithsesi, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos zbatohen në rast se Përfituesi dëshmon në mënyrë të pranueshme për Bankën praninë e fondeve të nevojshme për Projektin nga burime të tjera, me kushtet dhe specifikimet që janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

b) i) në bazë të nënparagrafit; ii) të këtij paragrafi: A) e drejta për të tërhequr të ardhurat nga bashkëfinancimi pezullohet, anulohet ose përfundohet ose tërësisht ose pjesërisht, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit; ose B) Bashkëfinancimi është bërë i kërkueshëm ose i pagueshëm para maturimit të rënë dakord. ii) Nënparagrafi: i) i këtij paragrafi nuk zbatohet nëse Përfituesi përcakton me pëlqimin e Bankës Botërore se: A) pezullimi, anulimi, përfundimi ose paramaturimi nuk janë shkaktuar nga paaftësia e Përfituesit për të përbushur detyrimet që rrjedhin për të nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit; dhe B) kur ka fonde të tjera të disponueshme sipas kushteve dhe specifikimeve që janë në përputhje me detyrimet e Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Banka Botërore ka përcaktuar pas Datës së Hyrjes në Fuqi se përpara kësaj date por pas datës së kësaj Marrëveshjeje, ka ndodhur një ngjarje që do ta çonte Bankën Botërore të pezullonte të drejtën e Përfituesit për të kryer tërheqje nga Llogaria e Grantit në rast se kjo Marrëveshje do të kishte hyrë në fuqi në datën e ngjarjes.

d) Përfituesi nuk ka përbushur njërin prej detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e huas që mban të njëjtën datë si kjo Marrëveshje, ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore, e cila parashikon një hua për të ndihmuar për financimin e një projekti pjesë e të cilit është ky Projekt (Marrëveshje Financimi e IBRD-së).



Neni 5

Hyrja në Fuqi; Përfundimi

5.01. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Bankës Botërore t'i paraqiten prova të pranueshme për plotësimin e kushteve të mëposhtme:

a) Përfituesi përgatit dhe miraton një Manual Operacional për Projektin, i cili është i pranueshëm për Bankën.

b) Përfituesi ka punësuar një specialist prokurimesh dhe një specialist për menaxhimin financiar me kualifikimet, përvojën dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.

c) Marrëveshja e Bashkëfinancimit është autorizuar plotësisht ose është miratuar nëpërmjet të gjitha veprimeve të nevojshme qeveritare dhe të tjera.

d) Është realizuar Marrëveshja e Huas e IBRD-së dhe të gjitha kushtet që i paraprijnë hyrjes së saj në fuqi, ose të drejtës së Përfituesit për të kryer tërheqje sipas Marrëveshjes së Huas së IBRD-së (të ndryshme nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje).

5.02. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve që rrjedhin prej saj përfundojnë në rast se Marrëveshja nuk hyn në fuqi pas nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e Marrëveshjes, me përjashtim të rasteve kur Banka Botërore, pas shqyrtimit të arsyeve të vonësës, përcakton një datë të mëvonshme për qëllimet e kësaj Pjese. Banka Botërore e njofton Përfituesin menjëherë për një datë të tillë të mëvonshme.

Neni 6

Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat

6.01. Përfaqësuesi i Përfituesit i përmendur në pjesën 7.02 të Kushteve Standarde është Ministri i tij i Financave.

6.02. Adresa e Përfituesit e përmendur në pjesën 7.01 të Kushteve Standarde është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks:

355-4222-8494

6.03. Adresa e Bankës e përmendur në Pjesën 7.01 të Kushteve Standarde është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kablllore:Teleks:Faks:

[INTBAFRAD]248423(MCI) ose1-202-477-6391

[INDEVAS]

Washington, D.C. 64145(MCI)

Rënë dakord në _____, _____,
në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

në cilësinë e Agjencisë Zbatuese të Fondit për
Mjedisin Global

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

PJESA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivi i Projektit është të mbështesë praktika të qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe të rrisë përfitimet monetare dhe jo-monetare të komuniteteve në zona të caktuara të Projektit, të cilat shtrihen kryesisht në zona të ngritura rurale të prekshme nga erozioni.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit

a) Forcimi i kapaciteteve të Përfituesit për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave, duke përfshirë:

i) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve për të zbuluar ndryshimet dhe për të dhënë informacion sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve për një periudhë ndërhyrjeje për të cilën do të bihet dakord;



ii) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve të shtrirë në dhjetë vjet, nëpërmjet të cilit parcelat e kampionuara për mbulim nga pyjet dhe volum pyjor ekzaminohen çdo vit për dhjetë vjet rresht;

iii) mbështetjen e planifikimit të menaxhimit të pyjeve në pyjet prodhuese të menaxhuara nga shteti, duke përfshirë zonat e mbrojtura;

iv) krijimin e Sistemit Shqiptar të Informimit për Pyjet;

v) forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë Rajonale të Pyjeve për të realizuar detyrimet e saj, duke përfshirë dhe monitorimin e pavarur të pyjeve; dhe

vi) regjistrimin e pyjeve dhe të kullotave që i janë transferuar komunave nga qeveria qendrore.

b) Realizimi i aktiviteteve për të fuqizuar përfituesit, duke përfshirë Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV), Shoqatat Komunale të Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave (SHKPPK), dhe fermerët për të përdorur praktika menaxhimi të qëndrueshëm të tokës dhe kullotave, duke përfshirë:

i) zbatimin e Planit Gjiner të Veprimit për të nxitur barazinë gjinore në menaxhimin e burimeve natyrore;

ii) mbështetjen e Grupeve Lokale të Veprimeve (GLV) për të kontribuar për strategjinë e zhvillimit;

iii) trajnimin e NJQV-ve dhe SHKPPK-ve për përdorim të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe tokave bujqësore; dhe

iv) nxitjen e gjenerimit të të ardhurave rurale nëpërmjet analizave të zinxhirit të vlerave, përgatitjes së planeve përpunuese dhe marketimit të produkteve pyjore afatshkurtra dhe afatmesme.

Pjesa 2. Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës

a) realizimi i aktiviteteve për të përgatitur dhe për të zbatuar Planet Komunale për Mikrobaset (PKM) për përmirësimin e menaxhimit të tokës, duke përfshirë

i) hartimin e udhëzimeve për përgatitjen e PKM-ve për nxitjen e përdorimit të integruar të burimeve natyrore;

ii) përgatitjen e PKM-ve për komunat e reja;

iii) përditësimin e Planeve ekzistuese Komunale të Menaxhimit të Pyjeve dhe të Kullotave (PKMPK), të cilat do të transformohen në KPM gjatë kohëzgjatjes së Projektit.

b) dhënia e granteve për përfituesit që i plotësojnë kriteret për realizimin e nënprojekteve.

c) forcimi i kapaciteteve të stafit të Drejto-rive Rajonale të Pyjeve, Zyrës së Pyjeve në Rreth, ZZHBR-së dhe i organeve të tjera të përfshira në shërbime bujqësore dhe pyjore, si dhe i aplikuesve të cilët do të realizojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në këtë Projekt.

Pjesa 3: Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore

Krijimi i mekanizmave financues për uljen e degradimit të tokës dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë:

a) përgatitjen e studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe krijimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe verifikimit për të përcaktuar masën e karbonit të sekuestruar nëpërmjet aktiviteteve të Projektit;

b) zhvillimin e mekanizmave për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit për t'u siguruar se ata të cilët përfitojnë nga shërbimet mjedisore i paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve; dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit; dhe

c) pilotimin e mekanizmit për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit në zona të përzgjedhura.

Pjesa 4: Mbështetje për Zbatimin e Projektit

a) Nëpërmjet realizimit të aktiviteteve për zbatimin e Projektit, duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore.

b) Ofrimit dhe instalimit të sistemit të informacionit për monitorimin e Projektit për nxitjen e gjurmimit efektiv të aktiviteteve të projektit; dhe realizimin e sondazheve, auditeve mjedisore, monitorimit dhe vlerësimit.

PJESA 2

EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

SEKSIONI I. MASAT

INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI

A. Masat institucionale

1. Ekipi i Menaxhimit të Projektit

Përfituesi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014, krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet



dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka, duke përfshirë dhe sigurimin e koordinimit të përgjithshëm të menjëhershëm dhe eficient, zbatimin e përditshëm të Projektit dhe komunikimin e lidhur me aktivitetet dhe rezultatet e Projektit.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

a) Jo më vonë se data 30 shtator 2014, Përfituesi krijon dhe më pas mban në funksionim gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit një Komitet Drejtues të Projektit me përbërje, mandat dhe terma reference që janë të pranueshme për Bankën.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e përmendur më sipër, Komiteti Drejtues i Projektit (KDP) drejtohet nga Ministria e Mjedisit dhe përfshin Drejtorin e Projektit, përfaqësues nga MM-ja, nga Autoriteti Menaxhues i MBZHRAU-së, AKM-ja, ZRPP-ja, AZHBR-ja, MF-ja, Departamenti për Programimin e Zhvillimit, Financimin e Ndhmës së Huaj, Këshilli i Ministrave, një kryetar komune dhe Federata Kombëtare e SHPPK-ve.

c) Përfituesi merr masa që KDP-ja të takohet të paktën dy herë në vit dhe është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë, ndër të tjera: i) ofrimin e udhëzimeve strategjike dhe të politikave; ii) lehtësimin e koordinimit të aktiviteteve të Projektit dhe kryerjen e rekomandimeve për eliminimin e pengesave për zbatimin e Projektit; dhe iii) rishikimin e progresit të bërë për arritjen e objektivit të Projektit.

3. Komiteti Teknik i Projektit

1. Përfituesi, jo më vonë se data 30 shtator 2014, krijon dhe më pas mban në funksionim gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, Komitetin Teknik të Projektit të drejtuar nga Drejtuesi i Projektit dhe që përfshin një Koordinator Projekt, koordinatorë sipas komponentëve dhe staf teknik nga MM-ja dhe agjenci të tjera të përfshira në zbatimin e Projektit, me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, duke përfshirë: i) ofrimin e sigurimit të cilësisë për aspektet teknike të Projektit; ii) miratimin e Planit dhe Buxhetit Vjetor të Punës për transmetim të mëtejshëm tek Banka; dhe iii) monitorimin e zbatimit të Projektit.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e paragrafit a) Përfituesi siguron mbledhjen e Komitetit Teknik të Projektit të paktën një herë në çdo dy muaj.

B. Masat për zbatimin

1. Manuali Operacional i Projektit

Pa u kufizuar në dispozitat e nenit II të Kushteve Standarde, Përfituesi garanton që:

a) Projekti të kryhet në përputhje me Manualin Operacional të Projektit, dhe

b) Manuali Operacional i Projektit, ose pjesë të tij të mos ndryshohen, hiqen, pezullohen ose shfuqizohen pa njoftimin paraprak me shkrim të Bankës, dhe në rast të mospërputhshmërisë së dispozitave të Manualit Operacional të Projektit me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

C. Planit dhe Buxheti Vjetor i Punës

1. Përfituesi përgatit dhe i jep Bankës jo më vonë se data 1 dhjetor e çdo viti fiskal gjatë zbatimit të Projektit një plan pune dhe një buxhet që përmban të gjitha aktivitetet e propozuara për t'u përfshirë në Projekt gjatë vitit fiskal pasardhës dhe një projekt-plan financiar për shpenzimet e kërkuara për këto aktivitete, duke parashikuar shumat e propozuara dhe burimet e financimit.

2. Përfituesi i jep Bankës mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me të për secilin nga planet e propozuara të punës dhe buxhetet, dhe sigurohet që Projekti të zbatohet me kujdesin e nevojshëm pas këtij viti fiskal, në përputhje me këto plane pune dhe buxhete, siç miratohen nga Banka (Planit dhe Buxheti Vjetor i Punës).

3. Përfituesi nuk bën ose nuk lejon të bëhen ndryshime në Planin dhe në Buxhetin e miratuar Vjetor të Punës pa miratimin paraprak me shkrim nga Banka.

D. Antikorrupsioni

Përfituesi siguron që Projekti të kryhet në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve të Antikorrupsionit.

E. Garancitë

Përfituesi e realizon Projektin në përputhje me dispozitat e KMM-së. Për këtë qëllim, nëse aktivitetet e përfshira në propozimin e Planit Vjetor të Punës dhe në Buxhet, bazuar në KMM, kërkojnë përgatitjen e një PME-je, Përfituesi siguron që të mos zbatohen aktivitete të tilla, me përjashtim të rasteve kur dhe derisa për këto aktivitete PME-je: i) të jenë përgatitur në përputhje me FME-në dhe t'i jenë dhënë Bankës si pjesë e Planit dhe e Buxhetit Vjetor të Punës; ii) të zhvendosen lokalisht siç



kërkohej nga FME-ja; dhe iii) miratohen nga Banka dhe njoftohen publikisht.

Seksioni II. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

A. Raportet e Projektit, Raporti Përfundimtar

1. Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranuar nga Banka. Çdo Raport Projekti mbulon një periudhë kalendarike gjashtëmuajore dhe i jepet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Përfituesi përgatit Raportin Përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti Përfundimtar i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Përfundimit. Për t'u ndihmuar gjatë përgatitjes së Raportit Përfundimtar, Përfituesi kontraktkon konsulentë; kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të pranueshme për Bankën në përputhje me dispozitat e pjesës III.

B. Menaxhimi Financiar, Raportet Financiare dhe Kontrolli Financiar

1. Përfituesi garanton që një sistem menaxhimi financiar të ruhet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

2. Përfituesi përgatit dhe i jep Bankës, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik, raporte të përkohshëm financiare të paaudituar për Projektin që mbulojnë periudhën tremujore, në një formë dhe mënyrë të pranueshme për Bankën.

3. Përfituesi i auditon Pasqyrat Financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të Kushteve Standarde. Secili kontroll i Pasqyrave Financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha i dërgohen Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të këtyre periudhave.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, Punimet dhe Shërbimet Jokonsulente. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin, të cilat financohen nga shuma e Grantit, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara, ose të përmendura në seksionin I të

Udhëzimeve të Prokurimeve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e Konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga shuma e Grantit prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara, ose të përmendura në seksionet I dhe IV të Udhëzimeve të Konsulentit dhe me dispozitat e këtij Seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me shkronja kapitale të përdorura më poshtë në këtë Seksion për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metoda të rishikimit të kontratave të caktuara nga Banka, i referohen metodës së përshkruar në seksionin II dhe III të Udhëzimeve të Prokurimit ose Seksioneve II, III, IV dhe V të Udhëzimeve të Konsulentit, sipas rastit.

B. Metoda të Veçanta të Prokurimit të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente

1. Tender i Hapur Ndërkombëtar. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

2. Metoda të Tjera të Prokurimit të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente. Për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për kontratat e specifikuar në Planin e Prokurimeve, të ndryshme nga Tenderët e Hapur Ndërkombëtarë, mund të përdoren edhe metodat e mëposhtme: a) Tender i Hapur Kombëtar, objekt i dispozitave shtesë të parashikuara në paragrafin 3 të këtij Seksioni; b) blerja; dhe c) kontraktimi i drejtpërdrejtë.

3. Modifikim i Procedurave të Tenderëve të Hapur Kombëtar. Procedurat e Tenderëve të Hapur Kombëtare (THK) bazohen në procedurat e Tenderëve të Hapur, siç përcaktohet në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643 i datës 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë t'i nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafit 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e "Tenderit të Hapur" siç përcaktohen në LPP-në e Shqipërisë zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga tenderimi dhe nuk ka preferencë të asnjë lloji për



ofertuesit kombëtarë në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet e zotëruara nga shteti në Shqipëri lejohen të japin ofertën e tyre vetëm nëse ato janë ligjërisht dhe financiarisht autonome dhe funksionojnë sipas ligjit tregtar të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi nuk përdoret si kriter kualifikues për ofertuesit;

c) Ofertat hapen në publik në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, në praninë e përfaqësuesve që dëshirojnë të marrin pjesë;

d) Subjektet prokuruese përdorin dokumente tip tenderimi, siç miratohen nga Banka;

e) Në rastin e ofertave me çmime më të larta në krahasim me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk skualifikohet pa miratimin paraprak të Bankës;

f) Për dorëzimin e ofertave përdoret një procedurë me një zarf të vetëm;

g) Post-kualifikimi realizohet vetëm me ofertuesin më të ulët; në kohën e hapjes së ofertave nuk refuzohet asnjë ofertë për shkak të kualifikimeve;

h) Ofertuesit në formën e një shoqërie aksionere kanë përgjegjësi ligjore të përbashkët dhe të shumëfishtë;

i) Para skualifikimit të të gjitha ofertave dhe para pranimit të ofertave të reja, merret miratimi paraprak i Bankës;

j) Kontratat i jepen ofertuesit më të ulët, i cili është mjaftueshmërisht përgjegjës dhe që përcaktohet se është i kualifikuar për të kryer aktivitetin në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të njoftuara më parë për vlerësimin;

k) Negociatat pas ofertimit me ofertën e vlerësuar si më e ulëta, ose me ofertues të tjerë nuk lejohen;

l) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më tepër se 18 muaj) përmbajnë kushtet e nevojshme për rregullimin e çmimit;

m) Ofertat dhe garancitë e kontratave bëhen sipas formatit të përfshirë në dokumentet e tenderit. Garancia e tenderit është e vlefshme për njëzet e tetë ditë (28) pas vlefshmërisë fillestare të ofertës, ose pas çdo periudhe zgjatjeje, nëse është e nevojshme. Asnjë pagesë paradhënie nuk mund të kryhet pa një garanci të përshtatshme për paradhënie.

n) Dokumentet e tenderimit dhe kontrata, siç konsiderohen të pranueshme për Bankën,

përfshijnë dispozitat që deklarojnë politikat e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët, të cilët janë identifikuar se janë përfshirë në mashtrim ose korrupsion, siç përkufizohet në Udhëzimet e Prokurimeve; dhe

o) Në përputhje me Udhëzimet e Prokurimeve, çdo dokument tenderues dhe kontratë e financuar me të ardhurat e Financimit parashikon që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit, dhe nënkontraktuesit, agentët, stafi, konsulentët, ofruesit e shërbimit, ose furnizuesit e tyre, të lejojnë Bankën të inspektojnë të gjitha llogaritë, të dhënat dhe dokumentet e tjera të lidhura me ofrimin e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe auditin e tyre nga audituesit e caktuar nga Banka. Aktet të cilat synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit dhe të drejtat e auditimit të Bankës, të parashikuara në Udhëzimet e Prokurimeve, përbëjnë praktikë penguese, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimeve.

Metodat e Posaçme të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në Cilësi dhe Kosto. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna bazuar në përzgjedhjen e bazuar në Cilësi dhe Kosto.

2. Metoda të tjera Prokurimi të Shërbimeve të Konsulentëve. Për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata të specifikuar në Planin e Prokurimeve, përveç metodës me Përzgjedhje të bazuar në Cilësi dhe Kosto, mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Përzgjedhja e bërë e Bazuar në Cilësi; b) Përzgjedhja sipas një Buxheti Fiks; c) Përzgjedhja e Bazuar në Koston më të Ulët; d) Përzgjedhja e Bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve; e) Përzgjedhja me një Burim të Vetëm për Kompanitë e Konsulencës; f) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzimeve të Konsulentit për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë, dhe g) Procedura me një Burim për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individë.

D. Rishikimi i Vendimeve të Prokurimeve nga Banka

Plani i Prokurimeve përcakton ato kontrata që do të jenë objekt i Rishikimit Paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i Rishikimit të Mëpasshëm nga Banka.

Seksioni IV. Tërheqja e të Ardhurave nga Granti



A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga Granti në përputhje me: a) dispozitat e Nenit III të Kushteve Standardeve; b) parashikimet e kësaj pjese, dhe c) me udhëzimet e tjera shtesë të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Përfituesit (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet për Projektet”, nxjerrë në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje në përputhje me këto udhëzime), për financimin në masën 100% të Shpenzimeve të Pranueshme, të cilat përbëhen nga mallrat, shërbimet dhe kostot operative, përfshirë taksat.

2. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga Granti në përputhje me: a) dispozitat e nenit III

të Kushteve Standardeve; b) parashikimet e kësaj pjese, dhe c) me udhëzimet e tjera shtesë të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Përfituesit (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet për Projektet”, nxjerrë në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje në përputhje me këto udhëzime) për financimin e Shpenzimeve të Pranueshme të parashikuara në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Granti (Kategori), ndarjen e shumave të Grantit për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranueshme në secilën Kategori:

Kategoria	Shuma e Grantit të alokuar (në dollarë amerikanë)	Përqindja e Shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Shërbimet jokonsulente, trajnime, shërbime konsulente dhe kosto operative sipas pjesës 1(a), 2(a) dhe pjesës 3 të Projektit	2,880,000	100%
SHUMA TOTALE	2,880,000	

A. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pa cenuar dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, tërheqja nuk pranohet për pagesa të kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Data e përfundimit e përmendur në seksionin 3.06 (c) të Kushteve Standarde është data 30 shtator 2019.

SHTOJCË

SEKSIONI I. PËRKUFIZIMET

1. “Sistemi i Informacionit për Pyjet në Shqipëri” është kuadri i teknologjisë së informacionit i projektuar për të marrë të dhëna ose informacion për pyjet dhe kullotat për të lehtësuar analizimin dhe raportimin e menaxhimit të integruar të pyjeve.

2. “Plani dhe Buxheti Vjetor i Punës” është plani i punës dhe buxheti i përgatitur çdo vit nga Përfituesi dhe i miratuar nga Banka në përputhje me seksionin C të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje; dhe “Planet dhe Buxhetet Vjetore të Punës” nënkuptojnë më shumë sesa një plan dhe buxhet vjetor të punës.

3. “Udhëzimet Antikorrupsion” janë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e

financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, datë 15 tetor 2006, të rishikuar në janar të vitit 2011.

4. “AZHBR” është Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural e Përfituesit e krijuar dhe që funksionon në përputhje me ligjin “Për zhvillimin bujqësor dhe rural”, nr. 9817, datë 22 tetor 2007 ose pasuesi ligjor i tij.

5. “Përfituesi” është marrësi i një granti IPAD sipas pjesës 2 (b) të Projektit.

6. “Kategori” është kategoria e parashikuar në tabelën në seksionin IV të pjesës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

7. “Bashkëfinancuese” është Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

8. “Bashkëfinancim” është shuma prej gjashtëdhjetë e pesë milionë koronash suedeze (SEK 65,000,000) që do të jepen nga Sida për financimin e Projektit.

9. “Marrëveshje Bashkëfinancimi” është Marrëveshja e Bashkëfinancimit e Sida-s.

10. “Shoqatat e Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave” janë organizatat joqeveritare që përfshijnë anëtarë të komuniteteve që përdorin



burime pyjesh dhe kullotash brenda një zone të një njësie rurale të qeverisë vendore.

11. “Plan për Menaxhimin Komunal të Pyjeve dhe Kullotave” ose “PMKPK” është një instrument menaxhimi i hartuar nga komunitetet, i cili parashikon masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e tokës së pyjeve dhe të kullotave për të paktën 10 vjet.

12. “Plani Komunal i Menaxhimit të Mikrobaseneve” ose PKMM-ja është një instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunitetet, i cili përshkruan masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e pyjeve, kullotave dhe tokës bujqësore për të paktën 10 vjet.

13. “Udhëzimet e Konsulentit” janë “Udhëzime: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve për Huat e IBRD-së dhe për Kreditë dhe Grantet e IDA-s nga Huamarrës të Bankës Botërore”, nxjerrë në janar të vitit 20113.

14. “Këshilli i Ministrave” është dega ekzekutive e Përfituesit, e drejtuar nga Kryeministri.

15. “Departamenti i Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndhmës së Huaj” është departamenti i krijuar në Zyrën e Kryeministrit dhe që funksionon në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 204, datë 1 nëntor 2013.

16. “Zyrat Pyjore të Rrethit” janë zyrat e Përfituesit në nivel rrethi të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

17. “Kuadri i Menaxhimit Mjedisor”, ose “KMM” është kuadri i përgatitur nga Përfituesi që mban datën 23 janar 2014, i njoftuar po në të njëjtën datë, ku parashikohen modalitetet për analizën dhe procedurat mjedisore për përgatitjen dhe zbatimin e planeve mjedisore të menaxhimit të bazuara në Projekt, dhe këto kushte përfshijnë të gjitha pjesët dhe shtojcat e KMM-së.

18. “Plani i Menaxhimit Mjedisor”, ose “PMM” lidhet me çdo aktivitet të bazuar në Projekt, mbështetur në të cilin KMM-ja kërkon një plan menaxhimi mjedisor. Ky plan përgatitet në përputhje me dispozitat e seksionit 1. E të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe “PMM-të” janë më shumë se një.

19. “Plan Gjinator Veprimi” është plani i përgatitur nga Përfituesi i datës 7 nëntor 2013, për të forcuar pjesëmarrjen e grave në të gjitha aktivitetet e projektit dhe që përbën pjesë të sistemit të

monitorimit dhe vlerësimit të Projektit.

20. “Marrëveshja e IBRD-së” është marrëveshja ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore e nënshkruar në të njëjtën datë me këtë Marrëveshje.

21. “ZRPP” është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Huamarrësit, e krijuar në përputhje me ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nr. 33/ 2012 ose pasuesve të tij.

22. “Plan Lokal Veprimi” është partneriteti ndërmjet subjekteve publike, private dhe shoqërisë civile në nivel rajoni për të zhvilluar zonën rurale.

23. “MBZHRAU” është Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit e Përfituesit ose pasuesi ligjor i saj.

24. “Autoriteti Menaxhues i MBZHRAU-së” është Departamenti i Zhvillimit Rural në MBZHRAU.

25. “MM” është Ministria e Mjedisit e Përfituesit, ose pasuesi ligjor i saj.

26. “MF” është Ministria e Financave e Përfituesit ose pasuesi ligjor i saj.

27. “Federata Kombëtare e SHPPK-ve” është një organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në territorin e Përfituesit.

28. “Inventari Kombëtar i Pyjeve” ose “IKP” është një regjistër i të dhënave mbi pyjet, të marra nga informacioni i ofruar nga imazhet satelitore, me qëllim krijimin e një vlerësimi kombëtar të mënyrës sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve brenda një periudhe të caktuar.

29. “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e Përfituesit, e krijuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29 janar 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare mjedisore dhe agjencive rajonale mjedisore” ose pasuesit ligjorë të tyre.

30. “Kostot Operative” janë kostot me rritje të arsyeshme graduale që dalin nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzime për pajisje, për stafin e MM-së dhe AZHBR-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, dietat për nëpunësit civil, pajisjet (duke përfshirë pagat për nëpunësit civilë), orenditë, materialet, dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe kostot e lëndës djegëse për vizitat në terren.



31. “Pagesa për Shërbime Mjedisore” është pagesa që u ofrohet individëve ose grupeve në këmbim të përdorimit ose praktikave të qëndrueshme të tokës.

32. “Pagesa për Shërbimet e Ujëmbledhësit” është pagesa që u ofrohet individëve ose grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të ujëmbledhësit.

33. “Ekipi i Menaxhimit të Projektit” është Ekipi i Përfituesit i përbërë nga stafi i caktuar nga MM-ja, Koordinatori i Projektit, specialisti i prokurimeve dhe stafi tjetër që do të rekrutohet për Projektin, në përputhje me seksionin I.A.1 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

34. “Udhëzimet e Prokurimeve” janë “Udhëzimet: Prokurimet e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente për Huat e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s nga Përfituesit e Bankës Botërore”, nxjerrë në janar 2011⁴.

35. “Plani i Prokurimeve” është plani i prokurimeve të Përfituesit për Projektin, i datës 29 prill 2014, dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit, siç përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të përmendur më sipër.

36. “Manuali Operacional i Projektit” është manuali i përgatitur në përputhje me Seksionin II. A të Pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe i konfirmuar si i pranueshëm nga Banka, i miratuar nga Përfituesi, ku përskruhen dhe përcaktohen procedurat dhe rregullimet institucionale për zbatimin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e Projektit.

37. “Drejtoria Rajonale e Pyjeve” është një njësi qeveritare brenda MM-së, përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave dhe me shërbime të shtrira në nivelin e qarqeve, e krijuar dhe në funksionim në përputhje me ligjin “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” nr. 9385, datë 4 maj 2005 ose dokumentet pasardhëse ligjore.

38. “Marrëveshja Bashkëfinancuese e Sida-s” është marrëveshja ndërmjet Përfituesit dhe Bankës, e cila ofron një grant në shumën prej gjashtëdhjetë e pesë milionë koronash suedeze (SEK 65,000,000)

për Bankën për të ndihmuar në financimin e Projektit; apo çdo ndryshim i mëvonshëm i kësaj Marrëveshjeje. “Marrëveshja Bashkëfinancuese e Sida-s” përfshin të gjitha shtojcat, tabelat dhe marrëveshjet që i bashkëlidhen Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të Sida-s.

39. “Trajnim” janë kostot e arsyeshme të lidhura me pjesëmarrjen në trajnime, seminare, vizita studimore të stafit të përfshirë në aktivitetet e Projektit, kostot e udhëtimit dhe dietat për pjesëmarrësit në trajnime, seminare dhe vizita studimore, kostot e lidhura me sigurimin e trajnerëve, marrjen me qira të ambienteve të trajnimit dhe seminareve, si dhe kosto të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgatitjen dhe realizimin e kursit të trajnimit, seminarit ose vizitës studimore (por duke përjashtuar kostot e shërbimeve të konsulencës).

VENDIM

Nr. 776, datë 19.11.2014

PËR DISA TË DREJTA TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, pika 5, 34, pika 5, 35, pika 3, e 36, pika 1, të ligjit nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/të saj, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, si më poshtë vijon:

a) nga 36 km deri 60 km, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë/muaj;

b) nga 61km deri 100 km, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë/muaj;

c) nga 101 km deri 150 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/muaj;



ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë/muaj;

d) mbi 200 km, në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të Shërbimit, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin që përkon me juridiksionin e njësisë strukturore të Shërbimit, në nivel vendor (në rrethin qendër qarku), ku punonjësi është caktuar.

2. Kur punonjësi i Shërbimit caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/të saj dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i ndërpret marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë në emër të bashkëshortes/bashkëshortit, deri në çastin e punësimit, por jo më shumë se 15 vite, në masën:

a) 50 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit;

b) 100 % të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 (një) vit deri në 10 (dhjetë) vjet;

c) 100 % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 (dhjetë) vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indekskohet me rritjen e pagave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

3. Punonjësit të Shërbimit për rezultate të larta në punë, për shkak të kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në realizimin e veprimtarive të Shërbimit, si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit, i jepet shpërblim deri në 1 (një) pagë mujore në vit. Ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë dhe mund të jepet përgjatë të gjithë vitit kalendarik.

4. Personeli i Shërbimit gëzon të drejtën e pushimit vjetor të pagueshëm, si më poshtë vijon:

a) Për personelin operacional me grada, pushimi vjetor i pagueshëm jepet i përshkallëzuar sipas niveleve:

- 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të lartë drejtues;

- 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues;

- 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të parë drejtues;

- 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit zbatues.

b) Për personelin pa grada, pushimi vjetor i pagueshëm jepet i përshkallëzuar sipas niveleve:

- 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues;

- 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të ulët drejtues dhe për punonjësit e nivelit ekzekutiv.

c) Për personelin mbështetës, pushimi vjetor i pagueshëm jepet 4 (katër) javë kalendarike.

Punonjësi i Shërbimit përfiton dhe të drejtën e pushimeve të pagueshme ose jo, në përputhje me aktet ligjore dhe Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

5. Punonjësi i Shërbimit trajtohet me pushim ose pagë shtesë për mbikohën normale të punës, në mbështetje të akteve ligjore në fuqi.

6. Punonjësi i Shërbimit trajtohet me veshmbathje një herë në vit, në masën e 1 (një) page mujore të vendit të punës.

7. Punonjësi i Shërbimit, që përfiton sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, nënkupton punonjësit e përcaktuar në pikën 1, të nenit 21, të ligjit nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, duke përjashtuar punonjësit e shërbimeve mbështetëse.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

9. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm që duhet të paraqesë punonjësi i shërbimit, që përfiton sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.

10. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 778, datë 19.11.2014****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR
PËR AGJENCINË PËR MBËSHTETJEN
E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, zëri “Shpenzime kapitale”, t’i shtohet fondi prej 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekësh.

2. Ky efekt të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2014.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 784, datë 19.11.2014****PËR KRIJIMIN E FONDIT NË
MBËSHTETJE TË INDUSTRIË
FASONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit buxhetor (Fondi) në mbështetje të industrisë fasone, si zë i veçantë brenda strukturës programore të ministrisë përgjegjëse për punësimin, nga buxheti i shtetit. Fondi fillon në vitin 2015 dhe do të përdoret për mbështetjen e industrisë fasone. Çdo vit Ministria e Financave përcakton shumën, që derdhet në këtë fond.

2. Fondi në mbështetje të industrisë fasone, përveç buxhetit të shtetit mund të ketë si burim financimi edhe donatorë apo institucione financiare.

3. Fondi mbështet punëdhënësit e industrisë fasone për nxitjen e punësimit, zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore për këtë industri, si dhe forma të tjera mbështetjeje, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

4. Të gjithë punëdhënësit e industrisë fasone, të cilët kërkojnë të mbështeten nga ky fond, duhet të regjistrohen në zyrat e punësimit.

5. Programet që do të mbështeten nga ky fond janë:

a) programet ekzistuese të nxitjes së punësimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) programet e formimit profesional për profesione të ndryshme të industrisë fasone, të përcaktuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

c) programet dhe format e tjera të mbështetjes për nxitjen e punësimit në profesione të nivelit të mesëm e të lartë, nëpërmjet investimeve të ndryshme në funksion të kësaj industrie.

6. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për menaxhimin e fondit.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, programohen në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

8. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



VENDIM
Nr. 786, datë 19.11.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I MUZEUT TË BASHKËJETESËS”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1/2014, TË KOMITETIT SHTETËROR TË MUZEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i Muzeut të Bashkëjetesës”, miratuar me vendimin nr. 1/2014, të Komitetit Shtetëror të Muzeve.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”,

me një vlerë të përgjithshme 173 091 780 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 173 091 780 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e buxhetit të

shtetit, të miratuara për vitin 2014, për Ministrinë e Kulturës, “Programi i trashëgimisë kulturore dhe muzetë”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Kulturës.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Sipas kartelës së pasurisë”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

7. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4 dhe 6, të këtij vendimi.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës në hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I MUZEUT TË BASHKËJETESËS"

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi		Vlera			SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Lekë/m ²		Lekë			
						Truall	Ndërtim	Truallit	Ndërtesë	Banesë	
1	Trashëgimtar Familja Kruja (Flutura Bala, Lejla Selfo, Muhamet Kruja, Erald Kruja, Elda Kruja, Myzafete Kruja, Alban Kruja)	8150	1/501	730	-	57126	-	41,701,980			sipas kartelës së pasurisë,bllokohet në favor te KM nr. 021301 ,DT 29.3.2013



2	Trashëgimtar Familja Kruja (Flutura Bala, Lejla Selfo, Muhamet Kruja, Erald Kruja, Elka Kruja, Myzafete Kruja, Alban Kruja)	8150	1/502	-	-	131,389,800					sipas kartelës së pasurisë kontratate nr. 012198, datë 18.10.2013
				2300	57126					-	-
TOTALI 3030 m Leke = 173'091'780											

VENDIM**Nr. 787, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË FËMIJËS FRIDIS TUSHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Fridis Tushe, në shumën 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 788, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. LIRI PODA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Liri Poda, në shumën 3 900 000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 789, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. ANXHELIKA HASANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr.1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Anxhelika Hasani, në shumën 190 000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr.790, datë 19.11.2014

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË ZNJ.ERMIRA BAKALLI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Ermira Bakalli, në shumën 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 791, datë 19.11.2014

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË ZNJ. SILVANA SEMINI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Silvana Semini, në shumën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 792, datë 19.11.2014

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. FJORI SHEHU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Fjori Shehu, në shumën 2 750 000 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr.793, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. GENTIAN DEMALIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Gentian Demaliaj, në shumën 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 794, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. MERITA KALANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Merita Kalani, në shumën 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 795, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. MAJLINDA XHEMA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Majlinda Xhema, në shumën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 796, datë 19.11.2014****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. MARK KOKAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mark Kokaj, në 2 731 000 (dy milionë e shtatëqind e tridhjetë e një mijë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 36 lekë